

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MUREBEST ARREDAMENTI ITALIANI” SH.P.K

Sot më datë 30 Tetor 2019, themeluesi, Besnik STOJKU ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “MUREBEST ARREDAMENTI ITALIANI” shpk
Themeluesi i shoqërisë është:

- Besnik Muhamet STOJKU i lindur më 20/02/1965 në Fier, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.033946003, me adresë: Lagja 11 Janari Fier, Shqipëri madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Vendosi themelimin e shoqëri “MUREBEST ARREDAMENTI ITALIANI” shpk me termat si me poshtë:

Neni 1:

Objekti

Në momentin e miratimit të këtij Statuti, objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:

Ne fushen e tregtimit me shumice e me pakice, import-eksport i mallrave industriale te llojeve te ndryshme, artikujve elektro-shtepiake, pjese nderrimi per makineri te llojeve te ndryshme, te metaleve te çdo lloji, te artikujve ushqimore, bujqesore e blegtorale, bime medicinale, pije alkoolike e etero vajore, makineri e pajisje te te ndryshme, vajra lubrifikante e karburante, pjese hidraulike, higjeno-sanitare, pajisje elektrike, te kozmketikes, bizhuteri, te materialeve te ndertimit, te artikujve te mobilerise se drurit te perpunuar, pajisje e makineri per perpunimin e drurit, pika prodhimi te mobilerise, kozmetikes, pika servisi per automjete, sherbime hotelerie, transport mallrash dhe udhetare, veprimtari private ne fushen e ndertimit, projektimit dhe zbatimit. Transport ndërkombe tar mallrash për të tretë e me qira. Sherbime konsulence, promovimi, promocioni, reklamimi, ne fushen e mobilerise, ne fushen financiare dhe juridike dhe cdo sherbin tjeter brenda dhe jashte vendit.

Neni 2:

Emri dhe selia e shoqërisë

Shoqëria është person juridik privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emertimin e saj “MUREBEST ARREDAMENTI ITALIANI” shpk.



Selia e Shoqëria ndodhet ne Fier ne adresën: Lagja 11 Janari, Rruga Ramiz Aranitasi, Nd.75/3, H.2, Ap.4 Fier, Shqipëri.

Shoqëria ka të drejtë të ndryshoj selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia e Shoqërisë nuk mund të përdoret nga shoqëri apo persona të tretë, pa miratimin paraprak të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4:

Regjimi Juridik

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parmin e reciprocitetit.

Ajo do të organizohet si një shoqëri me perjegjësi të kufizuar (Shpk).

Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitat e Aktit se Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Kreu II

Kapitali

Neni 5:

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 Lekë (dhjetë mijë) Lekë. Pjesëmarrja e

themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Besnik Stojku: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 (dhjete mijë) lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroj një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim me të njëjtat kushte që kërkoen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit themeltar të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të trashëgueshme në rrugë trashëgimie

Kreu III

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Neni 8:


Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Ortakëve është përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likujdiveve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përcaktuar në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e ortakëve në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një përsone i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e ortakëve.

Autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9:

Mënyra e thirrjes së asamblesë së ortakëve

Asambleja e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes e rendin e ditës dhe tu dërgohet të gjithë ortakëve jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblese.

Kur asambjela e ortakëve nuk është thirur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht rregullsisë.

Neni 10:

Marrja e vendimeve

Asambjela e ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përcaktuar në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjitha vendimet e Ortakëve do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Një vendim i paregjistruar në këtë regjistër do të quhet i pavlefshëm.



Neni 11: Administrimi

Asambleja emëron 1 ose më shumë persona fizik si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare e Biznesit. Në momentin e regjistrimit të këtij Statuti, Shoqëria drejtohet nga një Administrator.

Administrator i Shoqërisë është:

Z. Besnik Stojku lindur më 20/02/1965 në Fier, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.G50220022J, me adresë: Lagja 11 Janari Fier, Shqipëri.

Afati i emërimit të Administratorit përfundon më 30 Totor 2024. Administratori mund të riemërohet pas përfundimit të këtij afati pa asnje kufizim.

Ortakët kanë të drejtë të shkarkojnë Administratorin në çdo kohë.

Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Ortakët në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit për Shoqëritë.

Neni 12: Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakëve; përfaqësoj Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- b) kujdeset përmbi mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatis dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimive i paraqet këto dokumente përpëra Ortakëve përmiratim;
- d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmiratim, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) kryej regjistrimet dhe dërgoj të dhënrat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare e Biznesit;
- f) raportoj përpëra Ortakëve, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinë e Shoqërisë;
- g) Kryej detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Ortakët.



Administratorët janë të detyruar të thërasin asamblene e ortakëve kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton soe ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Shoqëria do të mbaj një regjistër të vendimeve nën kujdesin e Administratorit me qëllim reflektimin e çdo vendimi të Ortakëve.

Neni 13:
Përgjegjësia e administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërise apo të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, I ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka nënshkruar marrëveshjen për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, administrator detyrohet:

1. - Të kryeje detyrat e tij të përcaktuara në ligj, në mirëbesim dhe në interesim më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmëndje të vecantë ndikimit të veprimatarisë së shoqërisë në mjesht;
 - Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arrijen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - Të vlerësoj me përgjegjësi cështjet për të cilat merret vendim;
 - Të parandaloj dhe të mënjanoj rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personal me ato të shoqërisë;
 - Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka provën e barrës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.
 4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:



- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividend;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përvec padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penalë kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përsfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme.

Kreu IV

Viti finanziar ekspertët

Neni 14 :

Viti finanziar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qëndrën Kombëtare e Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 15 :

Ekspertët

Ekspertët ka për detyrë që të kontrollojë gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrolli eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushturara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorëzoj në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16 :
Mbajtia e llogarive

Shoqëria do mbajë llogaritë në Lekë dhe në monedhë të huaj.

Kreu V
Prishja dhe riorganizimi i shoqërisë

Neni 17 :
Prishja dhe likujdimi

Shpërndarja dhe prishja e shoqërisë mund të bëhet ne cdo kohë :

- a) me Vendim të Ortakëve;
- b) hapjen e një procedure falimentimi/likujdimi;
- c) me vendim gjykate;
- d) për arsyet tjetra të parashikuara nga Ortakët në çdo kohë.

Neni 18 :
Riorganizim i shoqërisë bashkim-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të mbledhjes së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 19:
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20:
Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MUREBEST ARREDAMENTI ITALIANI” SH.P.K

Ortaku:

Besnik STOJKU

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Besnik Stojku".